



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 20 dhjetor 2021
Nr.ref.:RK 1922/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI124/21

Parashtrues

Faik Kokollari

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme
Plm. nr. 69/2021 të 18 marsit 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Faik Kokollari nga Prizreni (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës). Parashtruesin e kërkesës e përfaqëson Arsim Bilalli, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Plm. nr. 69/2021 të 18 marsit 2021, në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PAKR. nr. 360/2020 të 26 tetorit 2020 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren PKR. nr. 235/2018, të 24 tetorit 2019.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, përmes të cilit pretendohet se janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të parashtruesit kërkesës të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 7 [Vlerat], nenin 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 5 korrik 2021, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 14 korrik 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Safet Hoxha dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
7. Më 9 gusht 2021, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
8. Më 25 nëntor 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe me shumicë votash i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 28 mars 2018, gjatë kontrollit rutinë të automjetit në pikën kufitare Merdare, Policia e Kosovës dhe Shërbimi Doganor i Kosovës kanë gjetur një sasi të caktuar të substancave psikoaktive/narkotike te parashtruesi i kërkesës dhe pala e tretë L.T.
10. Më 19 shtator 2018, Prokuroria Themelore në Prishtinë ngrii aktakuzë PP/I. nr. 81/2018, kundër parashtruesit të kërkesës dhe palës së tretë L.T .., për shkak të dyshimit të bazuar se si bashkëkryerës kanë kryer veprën penale, “blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273, par. 2, lidhur me nenin 31 të KPK-së”.

11. Më 24 tetor 2019, Gjykata Komunale në Prishtinë, me Aktgjykimin PKR. nr. 235/18 shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës dhe palën e tretë L.T., për shkak se kanë kryer veprë penale *“blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273, par. 2, lidhur me nenin 31 të KPK-së”*, dhe parashtruesi i kërkesës dhe pala e tretë L.T. janë dënuar individualisht me burgim 2 vjet si dhe gjobë në shumën prej 5000 euro.
12. Parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore, për shkak të shkeljeve të rënda të dispozitave të procedurës penale, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
13. Edhe Prokuroria ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore, për shkak të vendimit për sanksion penal, me propozim që aktgjykimi i ankimuar dhe i akuzuari të dënohen me dënime më të larta, ndërsa ankesa e parashtruesit të refuzohet si e pabazuar.
14. Më 26 tetor 2020, Gjykata e Apelit, me Aktgjykimin PAKR. nr. 360/2020, e aprovoi si të bazuar ankesën e Prokurorisë dhe e ndryshoi aktgjykimin e Gjykatës Themelore duke e ndryshuar dënimin me burg të parashtruesit të kërkesës prej 2 dy vjet burgim deri në 3 tri vjet e 6 muaj burgim, ndërsa refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar.
15. Në pjesën e arsytimit të aktgjykimit lidhur me ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Gjykata e Apelit deklaroi:

“[...] me këtë rast gjykata e shkallës së parë nuk e merr parasysh mënyrën e kryerjes së veprës penale meqë të akuzuarit paraprakisht kanë përgatitur veturën për bartjen e narkotikëve në mënyrë që kanë shkuar në Serbi, ku edhe kanë qëndrua deri sa të modifikohet dhe përgatitet për fshehjen e narkotikut, por edhe sasia prej 26.855.34 gram që është gjetur e fshehur në pjesën e modifikuar të veturës në vendkalimin kufitar në Merdar (kufiri Kosovë - Serbi) që njëherë tregon shkallën e lartë të dashjes dhe vendosmërinë e tyre për të kryer veprën penale, ndërsa veprimet e tyre i bënë me rrezikshmëri të lartë shoqërore, si me të drejtë tërheq vërejtjen edhe Prokurori në ankesën e tij. Prandaj, në praninë e këtyre rrethanave rënduese, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, dënimi i shqiptuar të akuzuarit është i butë, për çka me të drejtë tërheqë vërejtjen Prokuroria në ankesën e saj. Për këtë arsye Gjykata e Apelit e ndryshoi aktgjykimin e ankimuar dhe të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi është në harmoni me intensitetin e dëmtimit të vlerës së mbrojtur, me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, si kryerës, dhe se me këto dënime do të arrihet qëllimi i dënitimit i paraparë me nenin 41 të KPPK”.

16. Në pjesën e arsytimit të aktgjykimit përkitazi me ankesën e parashtruesit të kërkesës, Gjykata e Apelit deklaroi:

“[...] rrethanat të cilave u referohet në ankesë nuk kishin peshën e tillë që do të justifikonin një dënim me të butë Gjykata e Apelit nuk akcepton vetëm një konstatim të gjykatës së shkallës së parë, ku në faqen 14, kishte konstatuar në raport me të akuzuarin Faik Kokollari, kur konstaton se ai ka vepruar me dashje eventuale, kjo për faktin se për Gjykatën e Apelit nga rrethanat e

çështjes që rezulton të jetë kryer vepra penale nuk përmbushen elementet e dashjes eventuale, por kemi të bëjmë me dashje direkte nga fakti se ai ishte i vetëdijshëm dhe e dëshironte kryerjen e veprës, e kjo më së miri argumentohet me provat që janë administruar në shqyrtimin gjyqësor, ku të akuzuarit synonin që ta transportonin narkotikun për në Serbi, mirëpo në rastin e kontrollit kufitar ndalohen dhe të njëjtëve iu gjendet substanca narkotike në automjetin, e cila ishte e vendosur në bunkerin e automjetit”.

17. Sa i përket ankesës së parashtruesit të kërkesës në lidhje me tejkalimin e afatit ligjor të paraparë me dispozitën e nenit 369 të KPPK-së për përpilimin e Aktgjykimit, Gjykata e Apelit deklaroi:

“[...] kjo Gjykate gjen se është fakt se gjykata e shkallës së parë nuk e ka përpiluar aktgjykimin me shkrim në afat të përcaktuar me dispozitën e përmendur prej 30 ditësh e as që ka kërkuar vazhdimin e afatit nga kryetari i gjykatës, mirëpo me këtë rast duhet pasur parasysh edhe faktin se gjyqtarët e Gjykatës Themelore në Prishtinë janë të mbingarkuar me lëndë, atëherë mund të ndodhin edhe lëshime të tilla, të cilat sipas vlerësimit të kësaj Gjykate nuk ndikojnë në ligjshmërinë e aktgjykimit e as në drejtat themelore të palëve për gjykim në kohë të arsyeshme”.

18. Më 8 qershor 2020, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR. nr. 360/2020 të 26 tetorit 2020 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Themelore PKR. 235/18, të 24 tetorit 2019. Në kërkesën e tij, parashtruesi i kërkesës deklaroi, ndër të tjera, “*gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale nga neni 311 par. 3 të KPPK, sepse nga seanca e datës 27.05.2029 e deri në seancën e radhës të datës 24.10.2019 nuk është mbajtur asnjë seancë e që kanë kaluar me shumë se tre muaj, ashtu që gjykata është dashtë ta ketë parasysh këtë vonesë dhe shqyrtimin gjyqësor ta fillon rishtas, [...] përpilimin e aktgjykimit nga gjykata e shkallës së parë që ka ndodhur mbas 60 ditë, e që në pajtim me ligjin aktgjykimi është dashtë të përpilohet brenda 30 dite.*
19. Më 18 mars 2021, Gjykata Supreme, me Aktgjykimin Pml. nr. 69/2021, refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë së parashtruesit të kërkesës, duke mbështetur në tërësi aktgjykimet e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore.
20. Në arsyetimin e Aktgjykimit lidhur me pretendimin e parashtruesit të kërkesës, lidhur me mosmbajtjen e shqyrtimit të ri gjyqësor për shkak të skadimit të një periudhe më të gjatë se tre muaj, Gjykata Supreme deklaroi:

“[...] nga seanca e fundit gjyqësore, nga gjykata e shkallës së parë, kjo gjykatë vlerësoj se veprimi i këtillë i gjykatës paraqet shkelje relative të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 2 të KPPK, dhe ky veprim nuk ka pas ndikim në marrjen e vendimit të ligjshëm dhe pretendimin nuk e aprovojë”.

21. Në arsyetimin e Aktgjykimit lidhur me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për mos-shpallje brenda 30 ditëve, Gjykata Supreme deklaroi:

“Kjo gjykatë gjen se ky pretendim qëndron, por vlerëson se për këtë gjykata e shkallës së dytë e ka dhënë arsyetimin e drejtë dhe të plotë, në f. 4 të aktgjykimit, të cilin e mbështet edhe kjo gjykatë dhe kjo nuk paraqet shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes aktgjykimeve të kontestuar të gjykatave të rregullta janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 7 [Vlerat], nenin 30 [E drejta e të Akuzuarit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.
23. Më konkretisht, parashtruesi i kërkesës thekson “Në rastin konkret, mundësia e të akuzuarit që të ftojë dëshmitarë që potencialisht do të dëshmonin dhe deklaratat e tyre do të mund të përdroreshin si mjet prove në favor të tyre është mohuar kur nuk janë ftuar dëshmitarët e propozuar nga të akuzuarit dhe kësisoj është shkelur parimi i barazisë së armëve dhe mjeteve efektive juridike. Andaj, shkelja e këtyre dispozitave ligjore në fakt ka sjellë deri tek cenimii të drejtave të të pandehurve, respektivisht me këtë janë shkelur nenet Kushtetutës si në vijim:
Neni 3 - Barazia para Ligjit;
Neni 7 - (Vlerat) / Diskriminimit
Neni 31 – E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm
Neni 54 - Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave”.
24. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës konsideron se Gjykata Themelore “ka bërë shkelje esenciale nga neni 311 par. 3 me arsyetimin se duke u bazuar në procesverbalet e datës 28/01/2019 ku me aktvendim është caktuar seanca e rradhës për datë 16/04/2019 po ashtu në aktvendimin e këtij proces-verbali është caktuar seanca e rradhës për datë 27/05/2019, ndërsa që nga kjo datë deri më datë 24/10/2019 nuk është mbajtur asnjë seancë e që sipas përllogaritjes së periudhës kohore konstatohet se kanë kaluar më shumë se tre(3) muaj rrespektivisht rezulton gati pesë(5) muaj që nuk është mbajtur seance, ashtu që gjykata e shkallës së parë është dashtë që ta këtë parasysh këtë vonesë dhe të marrë Aktvendim që shqyrtimi gjyqësor të fillon RISHTAS dhe të shqyrtohen të gjitha provat e që në rastin konkret Gjykata e shkallës së parë si dhe Gjykata e shkallës së dytë kanë vepruar në kundërshtim të nenit 311 par. 3 duke mos e rrespektuar këtë dispozitë ligjore. Rrjedhimisht dispozita e nenit 383 par. 1 pika 1.1 shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale, si dhe neni 384 par 1 pika 1.12. neni 370 par 7 ku Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar të vërtetuar fakte të cilat janë kundërtënëse në deklaratat e cila dërgon deri tek përgjegjësia penale. Në rastin konkret ka konstatuar përgjegjësi penale ndaj një të pandehuri duke ju referuar deklaratës në mënyrë të gabuar. Me konstatimin e gabuar nga Gjykata e shkallës së Parë ka rrjedhë gjithashtu edhe konstatimi i gabuar edhe në gjykatën e shkallës së dytë dhe me pastaj edhe në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës ku është parashtruar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë.”
25. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se “Nga gjykata e shkallës së parë kanë vazhduar shkeljet siq është ajo nga nenet 123 par. 5 lidhur me nenin 257 par. 3 ngase aktgjykimin e ka bazuar në prova të pa pranueshme”.

26. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu deklaroi “Shkeljet esenciale nga gjykatat e rregullta ka pasur edhe mbi refuzimin e dëshmitarëve të propozuar me emër dhe mbiemër nga ana ime si mbrojtës dhe si rezultat i këtij refuzimi janë shkelur në mënyrë absolute të drejtat mbrojtjes ku kanë ndikuar në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë”.

27. Në fund parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të vendosë si në vijim,

“I APROVOHET si e bazuar Kërkesa për Kushtetutshmëri e paraqitur nga parashtruesi Av. Arsim Bilalli, me të dhënat si ne hyrje të kësaj kërkesë.

II KONSTATOHET se të njëjtit me Aktgjykimin PKR. nr. 235/18, i marrë nga Gjykata Themelore e Prishtinës, Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit dhe si Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, i është shkelur E drejta për Gjykim të drejtë dhe të paanshëm e paraparë në nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

III KONSTATOHET se në ndërlidhje me piken e II-të, janë shkelur edhe nenet 3,7,46 dhe 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

IV SHPALLET I PAVLEFSHËM Aktgjykimin PKR. nr. 235/18, i marrë nga Gjykata Themelore e Prishtinës, i datës 24.10.2019, si dhe Aktgjykimi i Gjykatës Apelit të Kosovës PAKR. nr. 360/2020 i datës 26.10.2020 dhe Aktgjykimi i marrë nga Gjykata Supreme e Kosovës Pml. nr. 69/2021 i datës 18/03/2021 , dhe çështja i KTHEHET NË RISHQYRTIM Gjykatës Themelore në Prishtinë.”

Dispozitat relevante ligjore

Kodi Penal i Kosovës

“Neni 31

Bashkëkryerja

Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për vepër penale.

[...]

Neni 273

Organizimi, drejtimi apo financimi i trafikimit të narkotikëve apo substancave psikotrope

1. Kushdo që organizon, drejton apo financon ndonjë prej veprave penale nga ky Kapitull, dënohet me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet.

2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni përfshin sasi të madhe të narkotikëve apo substancave psikotrope, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet.

Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës

“Neni 123

Marrja në pyetje në procedurë paraprake, deklarata në procedurë paraprake dhe mundësia hetuese e veçantë

[...]

5. Deklaratat e dhëna nga i pandehuri në çfarëdo konteksti, nëse janë dhënë në mënyrë vullnetare dhe pa shtrëngim, janë prova të pranueshme gjatë shqyrtimit kryesor kundër të pandehurit, por jo edhe kundër të bashkëpandehurve. Deklaratat e tilla nuk mund të shërbejnë si provë e vetme fajësuese apo vendimtare për dënimin e të pandehurit.

[...]

Neni 257

Rregullat e përgjithshme për prova

[...]

3. Gjykata nuk mund ta mbështesë vendimin e saj në prova të papranueshme.

[...]

Neni 311

Ndryshimi i përbërjes së trupit gjykues gjatë shtyrjes

1. Kur përbërja e trupit gjykues është ndryshuar, shqyrtimi gjyqësor i shtyrë fillon rishtas. Por, në rastin e tillë, trupi gjykues pas dëgjimit të palëve mund të vendosë që dëshmitarët dhe ekspertët të mos merren sërish në pyetje dhe të mos bëhet këqyrja e re e vendit, por të lexohen deklaratimet e dëshmitarëve dhe ekspertëve të dhëna në shqyrtimin e mëparshëm gjyqësor apo të lexohet procesverbali i këqyrjes së vendit.

2. Kur përbërja e trupit gjykues nuk ka ndryshuar, shqyrtimi gjyqësor i shtyrë vazhdohet para të njëjtit trup gjykues dhe kryetari i trupit gjykues shkurtimisht paraqet rrjedhën e shqyrtimit gjyqësor të mëparshëm. Por, edhe në këtë rast, trupi gjykues mund të caktojë që shqyrtimi gjyqësor të fillojë rishtas.

3. Kur shtyrja ka zgjatur më shumë se tre (3) muaj ose kur shqyrtimi gjyqësor mbahet para një kryetari tjetër të trupit gjykues, shqyrtimi gjyqësor duhet të fillojë rishtas dhe përsëri të shqyrtohen të gjitha provat.

[...]

Neni 384

Shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale

1. Shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale konsiderohet nëse:

1.1. përbërja e gjykatës nuk ka qenë në pajtim me ligjin ose kur në marrjen e aktgjykimit ka marrë pjesë gjyqtari i cili nuk ka qenë i

pranishëm në shqyrtimin gjyqësor, ose kur me vendim të formës së prerë është përjashtuar nga gjykimi; 1.2. në shqyrtim gjyqësor ka marrë pjesë gjyqtari i cili është dashur të përjashtohet;

1.3. shqyrtimi gjyqësor është mbajtur pa personat, prania e të cilëve në shqyrtim gjyqësor kërkohet me ligj, ose kur të akuzuarit apo mbrojtësit, pavarësisht nga kërkesa e tij, i është mohuar përdorimi i gjuhës së vet në shqyrtim gjyqësor dhe përcjellja e zbatimit të shqyrtimit gjyqësor në gjuhën e tij;

1.4. publiku është përjashtuar nga shqyrtimi gjyqësor në kundërshtim me ligjin; 1.5. gjykata ka shkelur dispozitat e procedurës penale lidhur me çështjen nëse ekziston akuza e prokurorit të autorizuar, propozimi i të dëmtuarit ose leja e organit publik kompetent;

1.6. aktgjykimin e ka marrë gjykata e cila nuk ka pasur kompetencë lëndore për gjykimin e çështjes.

1.7. gjykata me aktgjykim nuk e ka gjykuar plotësisht lëndën e akuzës;

1.8. aktgjykimi bazohet në provë të papranueshme;

1.9. i akuzuari i thirrur të deklarohet mbi fajësinë nuk e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës ose ndonjë pikë të saj dhe është marrë në pyetje para prezentimit të provave;

1.10. aktgjykimi ka tejkaluar akuzën;

1.11. me aktgjykim është shkelur dispozita e nenit 395 të këtij Kodi; ose

1.12. aktgjykimi nuk është përpiluar në pajtim me nenin 370 të këtij Kodi.

2. Shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale konsiderohet edhe kur gjatë procedurës penale, duke përfshirë edhe procedurën paraprake, gjykata, prokurori i shtetit dhe policia:

2.1. nuk kanë zbatuar ndonjë dispozitë të këtij kodi ose kanë zbatuar gabimisht; ose

2.2. kanë shkelur të drejtat e mbrojtjes, dhe kjo ka ndikuar ose ka mundur të ndikojë në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë.”

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

28. Gjukata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

29. Gjukata vëren se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Plm. nr. 69/2021, i 18 marsit 2021, është kontestuar edhe në kërkesën KI123/21, në të cilën parashtrues i kërkesës është pala e tretë L. T., Gjukata do t'i shqyrtojë këto dy kërkesa veç e veç.

30. Në këtë drejtim, Gjukata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjukata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

31. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me nenet 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht secilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
(Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor[...]”.

32. Sa i përket plotësimit të këtyre kushteve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, e cila konteston aktin e autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Pml. nr. 69/2021, të 18 marsit 2021 dhe i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka theksuar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe ka parashtruar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
33. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Paragrafi (2) i rregullit 39 të Rregullores së punës përcakton se:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

34. Gjykata vëren fillimisht se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ), dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpall një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të rregullit 39 të Rregullores së

punës(shih rastin KIO4/21, parashtues *Nexhmije Makolli*, aktvendim për papranueshmëri i 12 majit 2021, paragrafi 26; shih gjithashtu rastin KI175/20, parashtues *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, aktvendim për papranueshmëri i 27 prillit 2021, paragrafi 37).

35. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si „*qartazi e pabazuar*“ në tërësinë e saj ose vetëm përkritazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “*pretendime qartazi të pabazuara*”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “*të shkallës së katërt*”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*”; (iii) pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”; dhe në fund, (iv) pretendime “*konfuze dhe të paqarta*” (Shih: më saktësisht për konceptin e papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si “*qartazi të pabazuar*”, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si “*qartazi të pabazuara*”, Udhëzuesi Praktik i GJEDNJ-së për Kriteret e Pranueshmërisë i 31 gushtit 2019; pjesa III. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat qartazi të pabazuara, paragrafët 255 deri më 284; shih gjithashtu rastin KIO4/21, cituar më lart, paragrafi 27 si dhe rastin KI175/20, cituar më lart, paragrafi 38).
36. Në këtë kontekst, përkatësisht, vlerësimit nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtoj thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtuesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë (shih rastin KIO4/21, cituar më lart, paragrafi 28 si dhe rastin KI175/21, cituar më lart, paragrafi 39).
37. Në lidhje me këtë, parashtuesi i kërkesës pretendon se përmes aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me (i) nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 6 të KEDNJ-së, (ii) nenin 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit] të Kushtetutës dhe nën (iii) shkelja e nenit 3 [Barazia para Ligjit], nenit 7 [Vlerat], nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës. Në vijim, Gjykata do të shqyrtojë individualisht pretendimet të parashtuesit të kërkesës.

(i) Për sa i përket pretendimit për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së

38. Gjykata vëren se pretendimet e parashtuesit të kërkesës në lidhje me shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të GJEDNJ-së, kanë të bëjnë me mënyrën me të cilën gjykatat e rregullta kanë interpretuar KPPK në rastin e tij. Lidhur me këtë, ai thekson se Gjykata Themelore e ka shtyrë shqyrtimin gjyqësor për më shumë se tre (3) muaj dhe përkundër dispozitave të KPPK-së, përkatësisht nenit 311, paragrafit 3, i cili parasheh se nëse shqyrtimi gjyqësor shtyhet për më shumë se tre (3) muaj, do të fillojë shqyrtimi i ri në të cilin do të vlerësohen këto prova, Gjykata Themelore ka

vazhduar me shqyrtimin gjyqësor dhe ka marrë aktgjykim pa vazhduar shqyrtimin gjyqësor. Si rezultat i ndërprerjes së shqyrtimit gjyqësor, ka ardhur deri te interpretimi i gabuar i deklaratave të parashtruesit të kërkesës të dhëna në shqyrtimin gjyqësor përkundër dispozitave të KPPK-së, përkatësisht nenit 123, paragrafit 5 lidhur me nenin 257, paragrafit 3, përkitazi me mënyrën në të cilën gjykatat e rregullta kanë përdorur deklaratën e bashkëkryerësit në mënyrë analoge edhe te parashtruesi i kërkesës, gjë që ka ndikuar në dënimin e parashtruesit të kërkesës. Kjo shkelje e procedurës nuk është korrigjuar as nga Gjykata e Apelit dhe as nga Gjykata Supreme. Në të vërtetë, Gjykata Supreme edhe pse ka konstatuar se ka ndodhur një shkelje e tillë e procedurës, ka deklaruar se kjo nuk ka ndikuar në ligjshmërinë e aktgjykimit të Gjykatës Themelore.

39. Në lidhje me këtë, Gjykata fillimisht rikujton se Gjykata Kushtetuese nuk ka juridiksion për të vendosur nëse një parashtrues i kërkesës ka qenë fajtor për kryerjen e një veprë penale apo jo. Gjykata nuk ka juridiksion as të vlerësojë nëse gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe as të vlerësojë nëse gjyqtarët e gjykatave të rregullta kishin prova të mjaftueshme për të përcaktuar fajësinë e një parashtruesi të kërkesës (Shih: në këtë kontekst dhe, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI128/18, Parashtrues: *Limak Kosovo International Airport J.S.C.*, “*Adem Jashari*”, Aktvendim i 28 qershorit 2019, paragrafi 55; KI62/19, parashtrues: *Gani Gashi*, Aktvendim për papranueshmëri i 19 dhjetorit 2019, paragrafët 56-57; KI110/19, parashtrues: *Fisnik Baftijari*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 nëntorit 2019, paragrafi 40).
40. Gjykata thekson qëndrimin e saj parimor se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet faktike ose ligjore (ligjshmëria) që pretendohet të jenë kryer nga Gjykata Supreme ose nga një gjykatë tjetër e instancës më të ulët, përveç në masën që ato gabime mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Gjykata më tej rithekson se nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e “shkallës së katërt” në lidhje me vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Në të vërtetë, roli i gjykatave të rregullta është të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, në këtë drejtim, rastin e GJEDNJ-së *García Ruiz kundër Spanjës*, aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdorura atje; dhe shih gjithashtu rastet KI128/18, cituar më lart, paragrafi 56; dhe KI62/19, cituar më lart, paragrafi 58).
41. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të duhur dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të atillë që parashtruesi i kërkesës të ketë pasur gjykim të drejtë (shih, *inter alia*, rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i miratuar më 10 korrik, dhe shih rastin e Gjykatës KI110/19, cituar më lart, paragrafi 41).
42. Sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës lidhur me mbajtjen e shqyrtimit të ri gjyqësor në kundërshtim me nenin 311 të KPPK-së, gjegjësisht pas një periudhe më të gjatë se tre (3) muaj, Gjykata Supreme deklaroi se:

“ [...] nga seanca e fundit gjyqësore, nga gjykata e shkallës së parë, kjo gjykatë vlerësoj se veprimi i këtillë i gjykatës paraqet shkelje relative të

dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 2 të KPPK, dhe ky veprim nuk ka pas ndikim në marrjen e vendimit të ligjshëm dhe pretendimin nuk e aprovojë”.

43. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendoi në Gjykatën Supreme se në rastin e tij ka ardhur deri te shkelja e procedurës, sepse arsyetimi i gjykatave të instancave më të ulëta ishte i bazuar në prova të pranueshme siç kërkohet me nenin 123 dhe nenin 257 të KPPK-së. Në arsyetimin e saj në lidhje me pretendimet për interpretimin e gabuar të provave, Gjykata Supreme arsyetoi, ndër të tjera, se: *“pretendimi i mbrojtjes se gjykata e ka bazuar aktgjykimin në provë të papranueshme është pretendim i pabazuar, për faktin se gjykata [Themelore] aktgjykimin e ka bazuar edhe në deklaratën e të dënuarit L.T të dhënë në polici (në prezencën e mbrojtësit) i cili ka pohuar se për modifikimin e bunkerit ka qenë në dijeni edhe F. K. [parashtruesi i kërkesës]”; ai është marr vesh me [personin A.] ky konstatim paraqet një fakt shumë të rëndësishëm për gjykatën, se i dënuari F.K. ka qenë në dijeni për bunkerin dhe e ka njohur personin A., dhe ka ndejtë me të njëjtin, dhe kjo e bënë të pabazuar këtë pretendim nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë”.*
44. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme konstatoi se nga argumentet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës, edhe pse kishte lëshime procedurale nga Gjykata Themelore, këto pretendime hyjnë në kategorinë e shkeljeve relative procedurale sipas paragrafit 2 të nenit 384 të KPPK-së. Pra, në raste të tilla, shkeljet procedurale do të ndikojnë në ligjshmërinë e një vendimi të tillë, vetëm nëse do të kishin ndikim në vendimin e ligjshëm. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, ky lëshim procedural nuk ka ndikuar në ligjshmërinë e aktgjyimit të Gjykatës Themelore. Gjykata erdhi në këtë përfundim duke vlerësuar dhe interpretuar deklaratat dhe provat e shqyrtuara nga Gjykata Themelore, duke iu referuar provave dhe deklaratave të dhëna nga parashtruesi i kërkesës dhe aktorët e tjerë në polici në prani të mbrojtësit si dhe fakteve të tjera. Prandaj, Gjykata Supreme i shqyrtoi këto pretendime dhe deklaroi se pretendimet e tilla të parashtruesit të kërkesës ishin të pabazuara.
45. Prandaj, Gjykata konstaton që parashtruesi i kërkesës ka pasur mundësi të përfitojë nga procedura kontradiktore dhe se ka pasur mundësi që në fazat e ndryshme të procedurës t'i paraqesë pretendimet dhe provat të cilat i ka konsideruar si të rëndësishme për rastin e tij; ka pasur mundësinë për t'i kundërshtuar pretendimet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare; gjykatat e rregullta i kanë dëgjuar dhe shqyrtuar të gjitha pretendimet e tij, e të cilat, shikuar objektivisht, kanë qenë të rëndësishme për zgjidhjen e rastit të tij, dhe se arsyet faktike dhe juridike për vendimin e kundërshtuar janë paraqitur në detaje, dhe për këtë arsye procedura, e marrë në tërësi, ishte e drejtë (shih: *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 21 janarit 1999, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafët 29 dhe 30; shih gjithashtu rastin e Gjykatës KI22/19, parashtrues *Sabit Ilazi*, aktvendim i 7 qershorit 2019, paragrafi 42 si dhe rasti KI128/18, cituar më lart, paragrafi 58).
46. Prandaj, Gjykata vëren se arsyetimi i Gjykatës Supreme, duke iu referuar pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të ligjit penal, si dhe ligjit të procedurës penale, është i qartë dhe, pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata konstaton gjithashtu se procedurat në gjykatat e rregullta nuk ishin të padrejta apo arbitrare (shih: Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Pekinel kundër Turqisë*,

të 18 marsit 2008, nr. 9939/02, paragrafi 55; shih gjithashtu: në lidhje me këtë, ndër të tjera, rastin KI22/19, cituar më lart, paragrafi 43).

47. Gjykata rikujton se vetëm fakti që parashtruesi i kërkesës është i pakënaqur me rezultatin e vendimeve të gjykatave të rregullta ose përmendja e thjeshtë e neneve të Kushtetutës nuk është e mjaftueshme për të ngritur një çështje për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës duhet të ofrojë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih rastet e Gjykatës KI128/18, cituar më lart, paragrafi 61; dhe KI62/19, cituar më lart, paragrafi 59).
48. Prandaj, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se me vendimin e kontestuar është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.
49. Në fund, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së për shkak të interpretimit të gabuar dhe zbatimit të gabuar të ligjit të aplikueshëm janë (i) pretendime që bien në kategorinë e “shkallës së katërt” dhe si të tilla, këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

(i) Për sa i përket pretendimit për shkeljen e të drejtave të të akuzuarit, e drejtë e garantuar me nenin 30 të Kushtetutës

50. Sa i përket shkeljes së nenit 30 të Kushtetutës ose shkeljes së të drejtave të të akuzuarit, Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës pretendon, “*refuzimin e dëshmitarëve të propozuar me emër dhe mbiemër nga ana ime si mbrojtës dhe si rezultat i këtij refuzimi janë shkelur në mënyrë absolute të drejtat e mbrojtjes*”.
51. Edhe pse parashtruesi i kërkesës e thekson këtë pretendim si shkelje të nenit 30 të Kushtetutës, Gjykata vëren se të drejtat në të cilat thirret parashtruesi në thelb janë të drejta të mbrojtura me nenin 31 të Kushtetutës.
52. Bazuar në sa më sipër, Gjykata vëren se nuk do të merret në mënyrë të veçantë me këtë pretendim të parashtruesit të kërkesës, për shkak të faktit se lidhur me dëshmitarët, procedurës së provave dhe gjendjes faktike, Gjykata u mor me këtë pjesë të pretendimit në arsyetimin e pretendimit në lidhje me shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë, e drejtë e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.
53. Në fund, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e nenit 30 të Kushtetutës duhet të hidhen poshtë në mënyrë identike si pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës sepse janë (i) kërkesa që bien në kategorinë e “shkallës së katërt” dhe si të tilla, këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

(i) *Përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 3 [Barazia para Ligjit], nenit 7 [Vlerat], nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës*

54. Sa i përket shkeljes së të drejtave të garantuara me nenet 3, 7, 46 dhe 54 të Kushtetutës, Gjykata rikujton se sipas praktikës së themeluar gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata e shpall kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar në pajtim me kriterin (iii) të pretendimeve “*të pambështetura apo të paarsyetuara*” kur plotësohet një nga dy kushtet karakteristike, përkatësisht;
- a) kur parashtruesi i kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse kjo është qartazi e dukshme në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit (shih: në këtë drejtim, rasti i GJEDNJ-së *Trofimchuk kundër Ukrainës (vendim)* nr. 4241/03 i 31 majit 2005, shih gjithashtu *Baillard kundër Francës (vendim)* nr. 6032/04 i 25 shtatorit 2008);
 - b) kur parashtruesi i kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë provat materiale me të cilat do t'i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t'ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse vet Gjykata nuk vendos ndryshe (shih rastin KI166/20, parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, 5 janar 2021, paragrafi 42)
55. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës thjesht ka përmendur shkeljen e neneve 3, 7, 46 dhe 54 të Kushtetutës, megjithatë, parashtruesi më tej në kërkesë nuk jep një arsyetim më të detajuar se si janë shkelur këto nene.
56. Sa i përket këtyre pretendimeve, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës vetëm i përmend nenet përkatëse të Kushtetutës, por nuk shtjellon më tutje se si dhe përse ka ardhur deri te shkelja e këtyre neneve përkatëse të Kushtetutës. Gjykata rikujton se ajo ka theksuar vazhdimisht se vetëm referimi i neneve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së dhe përmendja e tyre nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet KI175/20, cituar më lart, paragrafi 81, KI166/20 cituar më lart, paragrafi 52, KI04/21 cituar më lart, paragrafët 38-39).
57. Prandaj, Gjykata konstaton se sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkeljen e të drejtave të garantuara me nenet 3, 7, 46 dhe 54 të Kushtetutës, Gjykata konkludon se kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar, pasi këto pretendime kualifikohen si pretendime që i takojnë kategorisë (iii) së pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*” sepse parashtruesi i kërkesës thjesht citoi një ose më shumë dispozita të Konventës ose të Kushtetutës, pa shpjeguar se si ato janë shkelur. Prandaj, këto pretendime të

parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës 39.

Përfundim

58. Prandaj, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara me nenet 3, 7, 30, 31, 46 dhe 54 të Kushtetutës duhet të deklarohen të papranueshme në tërësi si qartazi të pabazuara, pasi këto pretendime kualifikohen si pretendime që i takojnë kategorisë (i) së pretendimeve „të shkallës së katërt“; dhe kategorisë (iii) së pretendimeve „të pambështetura ose të paarsyetuara“. Rrjedhimisht, kërkesa në tërësi duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, më 25 nëntor 2021, me shumicë votash:

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Radomir Laban



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani